



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. të datës 07.03.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi, rekonstruimi dhe sanimi i defekteve të kanalizimeve në të gjitha fshatrat e Komunës së Prishtinës (Bardhosh, Barilevë, Besi, Bërnice, Busia, Grashtica, Hajvalia, Lebana, Llukar, Makoc, Matiqan, Mramor, Prugoc, Rimanishtë, Sinidoll, Siqevë, Slivovë, Sharban, Shkabaj, Tenezhdoll, Trudë, Vranidoll, Çakllavicë)" me nr. të prokurimit 616-23-278-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 005 511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. të datës 07.03.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi, rekonstruimi dhe sanimi i defekteve të kanalizimeve në të gjitha fshatrat e Komunës së Prishtinës (Bardhosh, Barilevë, Besi, Bërnice, Busia, Grashtica, Hajvalia, Lebana, Llukar, Makoc, Matiqan, Mramor, Prugoc, Rimanishtë, Sinidoll, Siqevë, Slivovë, Sharban, Shkabaj, Tenezhdoll, Trudë, Vranidoll, Çakllavicë)" me nr. të prokurimit 616-23-278-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 005 511.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Flamuri V" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 07.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 15.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi, rekonstruimi dhe sanimi i defekteve të kanalizimeve në të gjitha fshatrat e Komunës së Prishtinës (Bardhosh, Barilevë, Besi, Bërnice, Busia, Grashtica, Hajvalia, Lebana, Llukar, Makoc, Matiqan, Mramor, Prugoc, Rimanishtë, Sinidoll, Siqevë, Slivovë, Sharban, Shkabaj, Tenezhdoll, Trudë, Vranidoll, Çakllavicë)" me nr. të prokurimit 616-23-278-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 005 511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është si në vijim: Kriteri në FDT lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale nr. 9.1 dhe 9.2 i formuluar "*përvojë pune profesionale të fushës së kontratës (në ekzekutimin e projekteve të rrugëve) min. 10 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës së punës (kontratave me punëdhënësit)*" lidhur me menaxherin e projektit (kontratës) është kriter diskriminues/favorizues.

Për shkak të pretendimit si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 17.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar si prova Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit. Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimin e tij.

Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimin. Rrjedhimisht pretendimi është i pabazuar pasi që nga provat e administruara mund të vërtetohet e kundërta e pretendimit sipas elaborimeve në vijim.

Kontrata që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit është me vlerë të madhe. Për më tepër kjo kontratë manifeston një ndër projektet kryesore afatmesme për Komunën e Prishtinës. Fusha për të cilën bëhet fjalë (kanalizimet në fshatrat e Komunës së Prishtinës) paraqet një nga nevojat jo vetëm urgjente por edhe themelore për banorët e kësaj pjese. Rrjedhimisht kryerja e këtyre punëve duhet të bëhet nga një operator ekonomik profesional dhe kompetent për fushën përkatëse, i cili është dëshmuar mjaftueshëm në punë dhe detyra tjera të ngjashme. Mbi këtë bazë është vendosur ky kriter në DT sipas rekomandimeve të njësisë kërkuese.

Rrjedhimisht kriteri i kontestuar jo vetëm që nuk është diskriminues/favorizues siç pretendon parashtruesi, por në fakt është i domosdoshëm për realizimin me sukses të kontratës për të cilën është duke u zhvilluar ky aktivitet i prokurimit.


Pas analizimit të kërkesës për rishqyrtim e datës 07.03.2023 është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i pabazuar dhe si i tillë është refuzuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.03.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi sipas LPP.